

## **Vendim nr. 204, datë 18.06.2026**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

|                      |           |
|----------------------|-----------|
| Marsida Xhaferllari, | Kryesuese |
| Ilir Toska,          | Anëtar    |
| Genti Ibrahimi,      | Anëtar    |

në datën 18.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (Y) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** YLLI GURISHTA

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i plotë i vendimit nr. 00-2024-4190, datë 28.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 45, 71 e vijues të ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I**

1. Kërkuesi ka qenë me detyrë oficer i Forcave të Armatosura nga data 30.05.1979 deri në nxjerrjen në rezervë në datën 16.02.2000 me urdhrin nr. 16211, datë 07.02.2000 të ministrit të Mbrojtjes.

2. Në datën 28.01.2002 kërkuesi ka paraqitur kërkesë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë (*DRSSH-ja, Korçë*) për t’u trajtuar me pension të parakohshëm

për vjetërsi në shërbim (*pensionit i parakohshëm*). Pas shqyrtimit të kërkesës së tij, DRSSH-ja, Korçë, me vendim nr. 240, datë 05.04.2002, i ka lidhur pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 11.120 lekë, me të drejtë pagese nga data 16.02.2002, momenti kur i ka lindur e drejta. Masa e caktuar e pensionit është indeksuar ndër vite sipas rritjeve të bëra me vendime të Këshillit të Ministrave. Në fletën shoqëruese të përlllogaritjes së pensionit të kërkuarit evidentohet se ai ka 21 vjet vjetërsi shërbimi dhe sipas ligjit nr. 8521, datë 30.07.1999 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 8521/1999*), duke qenë se ka plotësuar moshën 47-vjeçare, i duhen 15 vjet shërbim, dhe duke marrë për bazë pagën referuese 28.362 lekë, e cila përfaqëson pagën bazë për gradë sipas viteve të shërbimit, është llogaritur 50% e kësaj page, në masën 14.181 lekë, 2% e pagës referuese për 6 vjet shtesë shërbimi 3403 lekë, gjithsej 17.584 lekë. Në këtë fletë shoqëruese nuk janë bërë përlllogaritje të tjera, por është shënuar se pensioni i fillon nga data 16.02.2002 dhe caktohet në masën fillestare 11.120 lekë, shumë e cila në fakt përfaqëson masën maksimale të pensionit në shkallë vendi në çastin e lindjes të së drejtës.

3. Kërkuar, duke mos qenë dakord me përlllogaritjen e masës së pensionit, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë me kërkesëpadi, me objekt ndryshimin e vendimit nr. 240, datë 05.04.2002 të DRSSH-së, Korçë për përcaktimin e pensionit të parakohshëm dhe detyrimin e palës së paditur për të caktuar pensionin e parakohshëm në bazë të neni 6 të ligjit nr. 8521/1999, si dhe detyrimin e saj që të paguajë vlerën e pensionit që rezulton nga moszbatimi i ligjit.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. (248)-112, datë 29.03.2016, ka vendosur pranimin e padisë sipas objektit të saj dhe ndryshimin e vendimit nr. 240, datë 05.04.2002 të DRSSH-së, Korçë për caktimin e masës së pensionit të parakohshëm ndaj kërkuarit, duke e detyruar palën e paditur të paguajë diferencat midis pensionit që duhet të caktohet 17.584 lekë në muaj plus shtesat eventuale në vite dhe pensionit të caktuar dhe përfituar realisht prej tij në masën fillestare 11.120 lekë në muaj, plus shtesat eventuale në vite, nga data 16.02.2002 kur i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm e deri në datën 27.06.2009, në shumën 766.959 lekë. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se DRSSH-ja, Korçë, në përlllogaritjen e masës së pensionit të parakohshëm, nuk e ka interpretuar drejt dispozitën ku ka referuar, nenin 11 të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me nenin 6 të ligjit nr. 8521/1999, pasi kufizimin e identifikuar me masën maksimale të pensionit në shkallë vendi e ka zbatuar për të gjithë dispozitën e për më tepër ka cenuar edhe

pikën “a” të dispozitës, pasi masa e pensionit të caktuar është më e ulët se masa 50% e pagës referuese, kur ligjvënësi ka parashikuar që masa 50% e pagës referuese përfitohet e paprekur, ndërsa vetëm shtesat sipas pikës “b” nuk duhet të tejkalojnë masën maksimale në shkallë vendi. Për rrjedhojë, kërkuesit i është caktuar një masë pensioni më e ulët sesa realisht duhej t’i përlllogaritej.

5. Në përfundim, ajo gjykatë ka vlerësuar se vendimi nr. 240, datë 16.04.2002, në kuptim të nenit 118, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, është një akt relativisht i pavlefshëm, pasi është nxjerrë në kundërshtim me ligjin ku ai referon, sepse me anë të këtij akti kërkuesit nuk i është njohur e drejta që i njihet vetë ligji kësaj kategorie përfituesish, por i është kufizuar si rrjedhojë e një interpretimi të gabuar të ligjit. Në këtë aspekt, referuar edhe fletës përlllogaritëse të dosjes së pensionit të kërkuesit, si dhe konkluzioneve të ekspertes në aktin e ekspertimit, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se pensioni fillestar i kërkuesit duhet të caktohet në shumën 14.181 lekë (50% e pagës referuese) plus 2% të pagës referuese për 6 vjet shtesë vjetërsi shërbimi 3403 lekë, gjithsej 17.584 lekë e më pas, mbi masën fillestare të pensionit 17.584 lekë, duhet të llogariteshin edhe shtesat në vite që realisht kanë pësuar pensionet e parakohshme në bazë të VKM-së për rritjen dhe indeksimin e tyre, të cilat sipas ekspertes rezultojnë në shumën 766.959 lekë. Sipas gjykatës së shkallës së parë, kërkuesi, me të drejtë, kërkon pagimin e diferencave të masës së pensionit deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura...” (*ligji nr. 10142/2009*), por rillogaritja sipas këtij ligji nuk do të ketë fuqi prapavepruese sipas parashikimit të nenin 29 të këtij ligji. Po sipas asaj gjykate, në rastin e kërkuesit, nga praktika e dosjes së përfitimit, ka rezultuar se DRSSH-ja, Korçë, me vendimin e datës 12.03.2012, i ka rillogaritur pensionin kërkuesit në bazë të nenit 29 të ligjit, por kjo vendimmarrje e saj nuk është objekt i këtij gjykimi. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim DRSSH-ja, Korçë.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3293 (86-2018-3674), datë 21.09.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se në lidhje me analizimin e përcaktimeve të ligjit të aplikueshëm në caktimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sikurse debatohet edhe në mosmarrëveshjen në shqyrtim, ka të detyrueshëm qëndrimet e gjykatës më të lartë, e për më tepër vendimin unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka fuqi ligjore dhe është i detyrueshëm për zbatim. Gjykata e apelit, në zbatim të këtij vendimi unifikues, si dhe përcaktimeve të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (*ligji nr. 49/2012*) për zbatimin e vendimeve të

Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe për më tepër të vendimeve unifikuese, ka vlerësuar se pretendimet e kërkuarit konsiderohen të pabazuara në ligj, për rrjedhojë edhe vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë që i ka çmuar të bazuara ato, me pasojë rillogaritjen dhe në vijim pagimin e diferencave nga data 05.04.2002 e në vazhdim, duhet ndryshuar. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuar.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4190, datë 28.10.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuar, duke arsyetuar se rekursi i paraqitur nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012, ekzistenca e të cilave mund ta bënte të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Ai kolegji, në respekt të standardit konventor dhe kushtetues të procesit të rregullt ligjor, si dhe në mbështetje të nenit 473/a të Kodit të Procedurës Civile, nga vlerësimi i rrethanave të mosmarrëveshjes objekt gjykimi të konstatuara prej gjykatave të faktit, vlerëson se nuk është parashtruar në rekurs asnjë argument i qenësishëm që të lidhet me një nga shkaqet për të cilat mund të ushtrohet e drejta e rekursit dhe se nuk është rasti për të vënë në diskutim ndonjë çështje ligjore që mund të shqyrtohet kryesisht nga gjykata.

8. Në datën 27.03.2026 kërkuar ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 08.04.2026.

## II

### Pretendimet e kërkuarit

9. **Kërkuar**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

9.1. Mosrespektimi i afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues duhet të trajtohet si një mosrespektim formal për shkak të pamundësisë së paraqitjes së tij për arsye shëndetësore. Gjykata duhet të dallojë neglizhencën nga pamundësia objektive, duke mos i atribuar kërkuarit faj procedural që nuk ekziston. Dispozitat ligjore lejojnë rivendosjen në afat kur ai është humbur për shkaqe të arsyeshme, duke synuar korrigjimin e situatave të pamundësisë objektive dhe jo penalizimin e individit.

9.2. Gjykatat kanë cenuar *parimin e sigurisë juridike*, pasi çështja e kërkuarit është e ngjashme me atë të trajtuar në vendimin nr. 74, datë 20.11.2025 të Gjykatës Kushtetuese. Kjo e fundit ka shfuqizuar kufizimet “jo më shumë se pensioni maksimal i pleqërisë”, duke urdhëruar rillogaritjen bazuar në skemën e plotë të pensionit. Po ashtu, ajo ka konstatuar antikushtetutshmërinë e VKM-së nr.

5/2010 dhe ligjit nr. 10142/2009 për uljen e pensionit. Mosllogaritja e saktë e pensionit shkakton varfëri të padrejtë për ish-ushtarakët. Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar ndryshimet ligjore prapavepruese për ushtarakët e liruar.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkesit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore për shqyrtimin paraprak të kërkesës.

11. Kolegji vëren se kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuuesin. Po kështu, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Kolegji vlerëson të theksojë se në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes.

12. Mbi këtë bazë, në vijim, Kolegji do të ndalet në një prej kriterëve të legjitimitetit, konkretisht atij *ratione temporis*, për të analizuar nëse kërkesa e kërkuarit është paraqitur brenda afatit ligjor, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës. Referuar jurisprudencës së Gjykatës, për llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, si datë e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes

depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka pohuar se i takon, në radhë të parë, Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e çështjes së saj të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve (*shih Ibrahim dhe të tjerë k. Shqipërisë, datë 14.01.2025, § 13*). Gjithashtu, GJEDNJ-ja është shprehur se në rastin kur Gjykata e Lartë ka njoftuar aplikantin në adresën e siguruar prej tij, është detyrë e këtij të fundit të ndjekë fatin e çështjes (*shih Panahori kundër Shqipërisë, datë 17.03.2026, §§ 13-14*).

13. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 28.10.2024, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 27.03.2026. Sipas informacionit të përcjellë me *e-mail*-in e datës 07.05.2026 nga sekretaria e Gjykatës së Lartë, vendimi i kundërshtuar nga kërkuesi është publikuar në faqen e saj zyrtare, duke u bërë i disponueshëm për palët në datën 25.11.2024, datë nga e cila kanë kaluar më shumë se 1 vit e 5 muaj deri në datën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Referuar po këtij informacioni, “*kërkuesi është njoftuar për vendimin edhe nominalisht në datën 25.11.2024*”, duke paraqitur bashkëlidhur edhe korrespondencën elektronike ndërmjet sekretarisë së Gjykatës së Lartë dhe kërkuesit. Për më tepër, Kolegji vëren re se në rastin konkret kërkuesi nuk ka ngritur asnjë pretendim në ankimin kushtetues individual lidhur me mungesën e njoftimit të vendimit nga Gjykata e Lartë.

14. Për sa më lart, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, si dhe faktin se Gjykata e Lartë e ka njoftuar kërkuesin për vendimin e tij, Kolegji vlerëson se për sa kohë kërkuesi nuk ka arritur të provojë në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme nga data në të cilën vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët, ankimi kushtetues individual konsiderohet se është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor, të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës.

15. Në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimimin *ratione temporis* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.